



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prenjend/Prodato Received/Delivered	31.05.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicema Quantity
SKPMBAHUK	2750/2021		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr.296/20121

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.869/18 të datës 15.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën e datës 24.01.2018 me numër A.nr.34/2018 të parashtruar nga ankuesja

ne adresë banimi Rruga "28 Nëntori", në Komunën e Vitisë, kundër organit të punësimit - Komuna e Vitisë në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me .nr.34/2018 e datës 24.01.2018, e parashtruar nga ankuesja
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 01-070/01-1014, i datës 09.01.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Vitisë.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Vitisë, që brenda afatit prej 15 ditësh të bejë zbatimin e këtij vendimi, duke i njohur ankueses të drejtën e realizimit të pagës sipas Akt Emërimit të dates 30.12.2011, dhe të njëjtës ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 18.12.2017 e tutje.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Vitisë, në pozitën „Përgjegjëse e të Hyrave“, sipas Akt vendimit, të Udhëheqësi të Personelit të Komunë së Vitisë, me numër protokoli 02112/1315 të datës 02.08.2011 i caktohet koeficienti 7,5, ndërsa me datë

30.12.2011 ankuesja e nënshkruan Akt-emërimin me numër 06-112/2554, për pozitën „Zyrtare Financiare” me koeficient tetë (8).

Ankuesja e pakënaqur me mos realizimin e pagesës me koeficientit tetë (8), sipas Akt emërimit me numër protokollit 06-112/2554, të datës 30.12.2011, me datën 18.12.2017 ka parashtruar ankese me numër protokollit 02-070/01-1014, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Vitisë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Vitisë, me datën 09.01.2018, me numër protokollit 02-070/01-1014, ka nxjerr vendim me të cilin e ka refuzuar, si të pa bazuar ankesën e ankueses

Ankuesja e pakënaqur me vendimin me numër protokollit 02-070/01-1014, të datës 09.01.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Vitisë, me datën 22.01.2018 përmes Postes së Kosovës nr.R.6011129, ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, e cila ankese është protokolluar me numër 357/2018, me datën 24.01.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.01.2018, kërkesën për përgjigje në ankese e ka proceduar tek Komuna e Vitisë, ndërsa me datë 02.02.2018 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankese nga Komuna e Vitisë, me provat e bashkangjitura faqe prej (1/5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.03.2018, me numër protokollit 1529/2018 ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.34/2018 i cilin e ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankueses

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër A.nr.34/2018 të datës 16.03.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.04.2018 ka iniciuar konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila me datën 15.04.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin numër A.nr.869/18, përmes se cilit ka aprovuar kërkesë padinë e ankueses, ka anuluar Vendimin e A.nr.34/2018 të datës 16.03.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Administrimi i Provave: Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin numër A.nr.869/18 i datës 15.04.2021 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër A nr. 34/2018 të datës 24.01.2018 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 09.01.2018, me numër protokollit 02-70/01-1014, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Aktvendimi të datës 02.08.2011 me nr. protokollit 02112/1315; Akt Emërimi i datës 30.12.2011; Lisat e pagave nga data 01.12.2017 deri me datën 31.12.2017; Përgjigje në Ankese e datës 02.02.2018, me numër protokollit 532/2018, me shkresat e bashkangjitura.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës, në procedurë të rishqyrtimit ka konstatuar se ankesa e ankueses *është pjesërisht e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja, me datë 30.12.2011 e ka nënshkruar Akt-emërimin me numër protokolli 06-112/2554, për pozitën „Zyrtare Financiare” me koeficient të pagës tetë (8).

Ankueses edhe pse i është caktuar koeficienti i pagës tetë (8), e njëjta përmes parashtrimit të pretendimeve ankimore ka deklaruar se realizon pagën sipas koeficientit 7.5. Lidhur me këtë çështje, ankuesja, me datë 18.12.2017 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 02-070/01-1014 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa ky i fundit, me datë 09.01.2018 ka nxjerrë Vendimin me nr.01-070/01-1014, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar, me arsyetimin se emërimi i ankueses është bërë në kundërshtim me dispozitat e aplikueshëm për avancim në karriere.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Vitisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me nr.01-070/01-1014 të datës 09.01.2018, për refuzimin e ankesës së ankueses, nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sepse në kohën kur ankuesja e ka nënshkruar Aktin e Emërimit për pozitën e punës *Përgjegjëse e Sektorit të Pronës*, me datë 30.12.2011, nuk ka qenë në fuqi Rregullorja Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, e cila ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë. Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 9 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës*, si dhe duke marr parasysh se ankuesja ushtron pozitën e punës „Zyrtare Financiare” sipas Akt Emërimi me numër protokolli 06-112/2554 të datës 30.12.2011 me koeficient të pagës tetë (8), Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e pagës sipas akt emërimit në fuqi, me koeficient të pagës tetë (8), është i bazuar, kështu që organi i punësimit, gjegjësisht Kryetari i Komunës së Vitisë është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative që ankuesja të realizojë pagën sipas Aktit të Emërimit për pozitën përkatëse, dhe të njëjtës ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 18.12.2017, kur ankuesja ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Vitisë.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 50 ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës*, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave, përkatësisht nenin 8 ku përcaktohet se: 2. *Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës*, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës, në mënyrë retroaktive nga data 30.12.2011, kur ankuesja e ka



nënshkruar akt emërimin, është i pa bazuar sepse, ankuesja me datë 30.12.2011 ka nënshkruar Aktin e Emërimit me numër protokolli 06-112/2554, ndërsa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Vitisë, i është drejtuar me ankesë me datë 18.12.2017, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 si dhe nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 296/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Gjykatës Themelore-Departamentin për Çështje Administrative;
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

